



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 16.07.2019

**Drejton mbledhjen:**

**Adnor Shameti - kryetar i Nënkomisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23 prill 2018
2. Seancë dëgjimore informuese me Ministrin e Shtetit për Diasporën, zotin Pandeli

Majko, lidhur me veprimtarinë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2018

**Marrin pjesë:**

Elona Hoxha, Eglantina Gjermani dhe Adnor Shameti.

**Mungojnë:**

Ediola Braho

**Të ftuar:**

Pandeli Majko – Ministër i Shtetit për Diasporën

Soana Jaupllari – Drejtore e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Yllka Lezo – Këshilltare për mediet

## HAPET MBLEDHJA

**Adnor Shameti** - Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Nënkomisionit për Diasporën, si pjesë e Komisionit të Jashtëm në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Kuorumi është i pranishëm. Në njoftimin për rendin e ditës jeni bërë me dije se ai përbëhet nga miratimi i procesverbalit së datës 23 prill 2018, mbledhjes paraardhëse të Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin dhe pika e dytë e rendit të ditës është seanca dëgjimore informuese me ministrin e Shtetit për Diasporën, zotin Pandeli Majko, lidhur me veprimtarinë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2018.

Ka ndonjë vërejtje për pikën e parë të rendit të ditës? Nuk ka.

Miratohet.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, dua të sqaroj se bazuar në nenin 102, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, komisionet dhe nënkomisionet parlamentare kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat për të dhënë shpjegime dhe sqarime të nevojshme, të mëtijshme për probleme të fushave ku ata janë individualisht përgjegjës, si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave apo deklaratave të miratuara nga Kuvendi.

Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve japin shpjegime dhe informojnë për çështjet që lidhen me veprimtarinë e tyre.

Në këtë kuadër, Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin ka thirrur në seancë dëgjimore Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, si dhe ministrin zotin Majko.

Në datën 7. 6. 2018 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave ka miratuar ligjin nr. 32 të vitit 2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” dhe në bazë të këtij ligji, neni 4, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është person juridik publik.

Ky fond menaxhon projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave, ose donatorët në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse.

Ndërkohë, në kreun II, neni 3 i ligjit nr. 16 të vitit 2018 “Për Diasporën”, ministri përgjegjës për Diasporën dhe Fondi për Diasporën, figurojnë si dy organe shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me Diasporën.

Neni 14, kreu III i ligjit nr. 32 i vitit 2018 përcakton se Fondi raporton për veprimtarinë vjetore e periodike të institucionit pranë ministrit përgjegjës, por edhe raporton për fondet e mbledhura dhe mënyrën e shpenzimit të tyre pranë Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë me kërkesë të tij.

Në vijim të kësaj baze ligjore kemi nisur procedurën për njoftimin e ministrit të linjës dhe Fondit për Zhvillimin e Diasporës. Para keni raportin vjetor të veprimtarisë së Fondit për vitin e kaluar, megjithëse nuk është vit i plotë kalendarik, për ato arsye që shpjegova më sipër.

Para jush sot kemi zotin Majko.

Zoti Majko, ju lutem bëni një relativitet të përmbledhur të gjetjeve dhe veprimtarisë për vitin e kaluar të këtij institucioni.

Faleminderit!

**Pandeli Majko** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është raportimi i parë që bën Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Siç e thatë edhe ju, është në zbatim të ligjit nr. 32 të vitit 2018 “Për Fondin e Zhvillimit të Diasporës”, ku sipas nenit 10, germa “ë” dhe neni 14, pika 1, ky Fond është i detyruar të paraqesë raportin vjetor në këtë nënkomision.

Duke qenë se është një institucion publik, jo administrativ, i cili merret me koordinimin dhe mbulimin e projekteve të diasporës, çështja e transparencës për publikun, sidomos edhe për Kuvendin e Shqipërisë merr një rëndësi të veçantë.

Bëhet fjalë për raportin e parë të vitit 2018, kur Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës sapo kishte filluar funksionimin e vet dhe menjëherë pas miratimit të ligjit në parlament, janë kaluar të gjitha aktet nënligjore, është miratuar struktura dhe Këshilli i Ministrave ka miratuar projektin e parë, i cili i dha jetë edhe fillimit të punës së personelit fillestar të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Në raportin e depozituar keni informacion të plotë jo vetëm për aktet për miratimin e strukturës, por edhe për veprimtarinë financiare, të detajuar, lidhur me buxhetin që është shpenzuar gjatë vitit 2018.

Unë nuk do të futem në hollësi, pasi për këtë do të shprehet drejtoresha e Fondit, por dëshiroj të them se sot që po bëhet ky raportim i parë, dëshiroj të shpreh kënaqësinë e fillimit të funksionimit të këtij fondi, pasi rezultatet janë vënë re jo vetëm gjatë vitit 2018, për të cilin po japim informacion, por edhe në vitin 2019 e në vazhdim.

Për më tepër, më lejoni t'ia jap fjalën, me lejen tuaj, drejtoreshës së Fondit.

**Adnor Shameti** - Faleminderit, zoti Majko!

Fjala për zonjën Jaupllari.

**Soana Jaupllari** – Faleminderit, zoti Ministër!

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të nënkomisionit,

Më lejoni të paraqes një pamje të përgjithshme të raportit vjetor të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka nisur aktivitetin e tij në muajin tetor të vitit 2018. Funksionimi fillestar u bazua në projektin e miratuar me VKM-në nr. 611, datë 17 tetor 2018 “Për financimin e projektit “Diaspora për zhvillim” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Në bazë të ligjit nr. 32 të vitit 2018, organet drejtuese të Fondit janë: Këshilli Drejtues i Fondit dhe drejtori Ekzekutiv. Këshilli Drejtues gjatë vitit 2018 ka zhvilluar 2 mbledhje në të cilat janë marrë gjithsej 7 vendime, që kanë konsistuar në emërimin e drejtorit Ekzekutiv, në miratimin e kriterëve të punësimit, miratimin e rregulloreve, strukturën organizative dhe akteve të tjera.

Gjithashtu, në datën 19 mars 2019, raporti vjetor 2018 u prezantua edhe para Këshillit Drejtues dhe me anë të vendimit nr. 2 të kësaj date edhe u miratua.

Sa i përket organigramës dhe punësimeve, struktura organizative e administratës së Fondit është miratuar me vendimin nr. 4 të Këshillit Drejtues në datën 26 tetor 2018. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka një organigramë të përbërë nga 3 drejtori, me një staf maksimumi prej 30 punonjësish. Marrëdhëniet e punës për këtë institucion rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

Në vitin 2018 procesi i rekrutimit të punonjësve të Fondit është kryer në përputhje me kërkesat për staf të parashikuar në projektin “Diaspora për Zhvillim”, i cili ka qenë i vetmi burim financimi që ka pasur institucioni në vitin 2018. Janë zhvilluar 6 procedura standarde për kriteret e punësimit dhe rekrutimin e personelit.

Për sa i përket analizës financiare, siç e thashë edhe më sipër, veprimtaria fillestare e institucionit bazohet në projektin e financuar nga qeveria shqiptare me VKM nr. 611 “Diaspora për zhvillim”. Ky projekt do të jetë me një afat kohor 3-vjeçar me një shumë totale përafërsisht 100 milionë lekë. Sipas po të njëjtit vendim të Këshillit të Ministrave për vitin 2018 u vu në dispozicion fondi prej 4 milionë e 78 mijë e 811 lekësh.

Analiza financiare për vitin 2018 është e bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, gjithashtu, ka qenë konform kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Gjatë vitit 2018 institucioni ka menaxhuar, siç e thashë edhe më sipër, një fond prej rreth 4 milionë lekësh. Buxheti është realizuar në masën 68%.

Lidhur me pasqyrën e shpenzimeve, ato kryesisht konsistojnë: në shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime për aktivitete, shpenzime për ndërgjegjësimin dhe komunikimin të realizuara në masa, të cilat janë shprehur edhe në raport.

Gjithashtu, gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2018 u ndoq edhe projektbuxheti për vitin 2019 dhe buxheti i akorduar dhe miratuar për vitin 2019, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 611, është në shumën 45 milionë lekë.

Për sa i përket procesit të prokurimeve, gjithsej gjatë vitit 2018 janë realizuar dy procedura prokurimi me vlerë të vogël për sa i përket eventit lançues të projektit “Diaspora për yhvillim” dhe aktivitetit për informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për objektivat e Fondit, po në të njëjtin projekt, në ditën ndërkombëtare të migracionit.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës gjithashtu synon të jetë aktiv në marrëdhëniet me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare duke formalizuar nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe bashkëpunimin në fushën e Diasporës dhe Migracionit.

Gjatë vitit 2018 gjithashtu institucioni është angazhuar për të qenë pjesë e disa marrëveshjeve dhe memorandumeve të mirëkuptimit, një pjesë e të cilave është ende në proces negociimi midis palëve. Konkretisht, nga marrëveshjet e cituara në raportin e vitit 2018 është realizuar memorandumi i mirëkuptimit midis Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe fondacionit italian për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e diasporës, zhvillimit të projekteve, kërkimit dhe inovacionit, për pjesëmarrje të përbashkët edhe në programet e kornizës europiane.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem në dispozicion të pyetjeve dhe informacioneve të mëtejshme.

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – A keni pyetje?

**Elona Gjebrea** - Faleminderit!

I gjithë raporti që keni sjellë është i detajuar dhe ju përgëzoj për punën e bërë dhe ngritjen e reputacionit të ministrit të Shtetit në kuadër të të gjitha aktiviteteve që mbështesin punën e ministrit.

Projekti “Diaspora në zhvillim”, duket i plotësuar me të gjithë komponentët që duhet të kenë projekte të tilla. Pyetja ime ka të bëjë me atë që ju keni bërë për të thithur fonde të tjera dhe si e parashikoni situatën në vazhdim. Unë mendoj se duhet të ketë një vazhdimësi për mbështetje me projekte të ndryshme për aktivitete kaq të rëndësishme që mbulon institucioni juaj.

**Pandeli Majko**- Ju kërkojmë ndjesë nëse nga pikëpamja e zhvillimit të aktiviteteve shikoni ndonjë limit, por bëhet fjalë për një raportim, i cili përfshin vetëm disa muaj, një periudhë shumë të shkurtër mujore të vitit 2018 pasi është fjala për raportim vjetor të vitit 2018. Nëse do të flisnim pastaj për raportimin vjetor të vitit 2019, të cilin do t’jua dërgojmë shumë shpejt, shpresoj në muajin shtator ose tetor, do të përfshihet samiti i dytë i diasporës, do të përfshihet një projekt i dytë i miratuar nga qeveria shqiptare dhe tani që po flasim është në ecje e sipër një projekt i tretë. Ndërkaq do të japim një informacion të hollësishëm edhe për projektet që ne kemi negociuar ose jemi në negociatë e sipër me institucione të rëndësishme duke filluar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë. Ajo që është e rëndësishme do të thosha se edhe Banka Botërore edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë rënë dakord që çështja e buxhetimit ose trajtimit buxhetor të politikës së re shtetërore për strategjinë e diasporës do të futet në buxhetin trevjeçar të këtyre institucioneve.

**Adnor Shameti**– Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit!

Unë mendoj se kemi marrë vendimin e duhur të gjithë bashkë duke votuar këtë fond dhe mendoj se do të ketë impakt në bashkëpunim me diasporën kudo në botë.

Meqenëse vërtetë janë pak 2 muaj punë në vitin 2018, unë do të doja një përshkrim të shkurtër nga ana përmbajtësore të disa aktiviteteve që ju keni realizuar në vitin 2018, sepse ka të bëjë me mënyrën si e keni prezantuar fondin, mënyrën si është pritur fondi i zhvillimit të diasporës, i cili dhe u ka paraprirë më pas të gjitha aktiviteteve që ju keni realizuar ose po realizoni në vitin 2019. Për mua është e rëndësishme të dëgjoj nga ana juaj më shumë nga pjesa e përmbajtjes, pra 2 ose 3 nga aktivitetet që ju keni filluar punën për ta lancuar fondin, si është mirëpritur edhe nga shqiptarët në botë, që e theksoj u ka paraprirë të gjitha aktiviteteve që ju po realizoni tani. Si e

mendoni punën në të ardhmen? Fillimi i punës dhe pritja që ju kanë bërë shqiptarët ju kanë ndihmuar, por si ju ndihmon në punën në vazhdimësi?

**Adnor Shameti**- Fjala për drejtoreshën e Fondit.

Faleminderit!

**Drejtoresha** - Projekti “Diaspora për zhvillim” është një projekt, siç u shprehëm dhe më sipër, trevjeçar. Aktivitetet e projektit janë të fokusuar në rrjetet e profesionistëve të diasporës, në rrjetet e bizneseve të diasporës dhe rrjetet e grave, gjithashtu.

Sa u përket aktiviteteve që janë zhvilluar në vitin 2018, i pari ishte projekti lançues për zhvillimin e diasporës. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i institucionit të aktorët e interesuar për misionin e institucionit të sapongritur dhe interesi për të krijuar ura bashkëpunimi dhe ndërlidhëse me të gjithë partnerët e interesuar. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, gjithashtu, ka qenë pjesë e disa aktiviteteve të tjera të zhvilluara në vitin 2018, konkretisht ka qenë pjesë e aktivitetit të organizuar nga Banka Botërore në qytetin e Beratit. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është, gjithashtu, pjesë e grupit konsultues lidhur me këtë projekt në bashkëpunim edhe me Bankën Botërore.

Aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm është ai i zhvilluar në datën 12 dhjetor të vitit 2018 në bazë edhe të memorandumit të mirëkuptimit për emitancat të nënshkruar në vitin 2017 nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, ministri i Shtetit për Diasporën, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës ka qenë i pranishëm në tryezat e konsultimit dhe në aktivitetet e përbashkëta të zhvilluara.

Gjithashtu, edhe në aktivitetin e zhvilluar në datën 18 dhjetor 2018, për Ditën Kombëtare e Diasporës, organizuar nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe Organizata Ndërkombëtare e Emigracionit, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka marrë pjesë në bashkëpunim edhe me partnerët e sipërpërmendur.

Sa i takon aktiviteteve, të cilat do të zhvillohen në vitin 2019, ato janë në përputhje me objektivat e projektit, siç u shpreh edhe më sipër, janë në funksion të rrjeteve të diasporës shkencore, kryesisht rrjeteve të profesionistëve, rrjeteve të grave dhe të bizneseve. Realisht komunikimet me përfaqësues të këtyre rrjeteve janë rritur ndjeshëm dhe janë bërë shumë intensive. Ne vazhdimisht jemi në komunikim lidhur edhe me aktivitetet që do të zhvillojmë. Në muajin shtator do të kemi një aktivitet shumë të rëndësishëm në bashkëpunim me institutin Albshkenca, i cili është i fokusuar te diasporat shkencore dhe kontributi që sjell në fusha të ndryshme dhe në

këtë kuadër në këtë event jemi duke u organizuar dhe duke komunikuar realisht në mënyrë shumë më intensive me rrjetet e diasporës shkencore në mënyrë që kontributi i tyre të jetë i plotë.

**Adnor Shameti**- Faleminderit!

E dëgjova me vëmendje zotin Majko kur parashtrori elementet e bashkëpunimit me FMN dhe Bankën Botërore për mbështetjen të ardhmen ose bashkëpunimi me Fondin Shqiptar të Diasporës. Unë do të doja të dija cili është vizioni juaj në përputhje me atë çfarë kemi kaluar në ligjin përkatës, duke nisur nga fakti që në raportimin periodik për vitin 2018 thoni që gjithë pjesa modeste e fondeve ka qenë nga buxheti i shtetit? Cili është vizioni juaj për të ardhmen, ekzistencën e fondit, mënyrën e financimit, atë të thithjes së donacioneve të huaja, si nga diaspora, si nga donatorë të ndryshëm? Këtë informacion e duam më të detajuar. Çfarë pritshmëri keni në të ardhmen për vitin 2019 dhe më tej në përputhje me misionin që ka Fondi i Diasporës?

**Pandeli Majko** – Faleminderit, zoti kryetar për pyetjen!

Fondi është duke e zhvilluar aktivitetin e tij në funksion të ligjit dhe ky Fond si një institucion publik është një precedent deri diku i rrallë, në kuptimin që një institucion i tillë funksionon me ligj të veçantë. Arsyeja ka qenë që kur është diskutuar në këtë komision të nderuar me qëllim që t'u japim garanci të plotë donatorëve dhe palëve të tjera, të cilat do të duan t'i hedhin fondet e tyre për projekte afatgjata në fushën e diasporës lidhur me qëndrueshmërinë e institucionit.

Fakti që ne sot vijmë dhe raportojmë në mënyrë të hollësishme një dokument, i cili do të jetë dhe është publik jo vetëm për Kuvendin, por edhe për publikun e gjerë, për të gjithë transparencën e shpenzimeve që tregon se kjo është në vazhdim të garancive afatgjata që Fondi Shqiptar i Zhvillimi ofron në marrëdhënie me donatorët.

Siç jua thashë për vitin 2018, për arsye të marrjes së parë të oksigjenit, pra të realizimit të fillimit të punës administrative, sot që jemi duke folur Fondi ka marrë me një vendim të veçantë të qeverisë edhe godinën ku ka filluar funksionimin e vet administrativ, si dhe është duke negociuar me shumë donatorë dhe ka krijuar një ekip të mirë, të mjaftueshëm njerëzish, të cilët kanë eksperiencë konsistente sa u përket marrëdhënieve me donatorët dhe për realizimin e projekteve. E ardhmja, nuk dua të shprehem me optimizëm metaforik, por në mënyrë racionale do të thosha se është e lidhur me faktin e qëllimit të projektligjit. Jo të gjitha projektet apo buxhetet që do të duhen për zhvillimin e komunikimit midis diasporës dhe Shqipërisë do të zhvillohen me fondet e buxhetit të shtetit, një pjesë e rëndësishme e tyre do të zhvillohen me fondet e donatorëve, ku do



të kenë pjesën e tyre edhe komunitetet shqiptare jashtë vendit, por mbi të gjitha besoj se fillimi i mirë i punës i Fondit Shqiptar të Zhvillimit është garanci sa i përket kontiunitetit, por sidomos asaj për të cilën jemi sot këtu transparencës së çdo qindarke të harxhuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti Majko!

A ka drejtoresha ndonjë gjë për të shtuar?

**Soana Jaupllari** – Së pari, dëshiroj t’ju falënderoj për ftesën që na keni bërë për të qenë të pranishëm në mbledhjen e sotme!

Gjithashtu, dua t’ju them se qëllimi dhe synimi që ka Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, siç u shpreh edhe zoti ministër, e tejkalon një praktikë administrative të zakonshme. Sigurisht, komunikimi me diasporën dhe me komunitetet e diasporës kërkon vërtet shumë përpjekje dhe cilësi, por mbi të gjitha kërkon përkushtim. Në këtë aspekt dua t’ju them se lidhur me të gjitha projektet që Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po zbaton, patjetër që ne do të kemi përkushtimin e duhur që puna të jetë sa më cilësore.

Ju faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit!

A ka ndonjë nga kolegët pyetje, pasi pyetjet që u bënë ishin në formën e diskutimeve prandaj po e quajmë të ezauruar këtë pjesë?

Fjalën e ka zonja Gjermani.

**Eglantina Gjermani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua ta falënderoj zotin ministër edhe drejtoreshën, jo vetëm për faktin që jeni këtu pranë nënkomisionit, por edhe për gjithë publikimin e aktiviteteve tuaja, por edhe për transparencën, qoftë nga ana e ministrit për Diasporën apo të Fondit për Zhvillimin e Diasporës, për prezantimin e punës me një metodë të re, si dhe të bërjes transparente të saj në mënyrë periodike. Ne si anëtarë të nënkomisionit jemi gjithmonë të mirinformuar, po ashtu edhe Komisioni i Jashtëm. Unë besoj se e gjithë puna ose praktika e punës së Fondit, siç e thatë edhe ju, është jo e zakonshme, duke qenë një Fond me ligj të veçantë i miratuar nga ana jonë, prandaj për këtë arsye i dhamë një status të tillë për të gjitha specifikat që ka në marrëdhënie me diasporën. Unë mendoj se ky është një model shumë i mirë pune për t’u ndjekur dhe për t’u aplikuar edhe nga ana institucioneve të tjera.

Ju uroj shumë suksese dhe do të mirëpresim raportimin për vitin 2019 në momentin që do të mbarojnë të gjitha aktivitetet, por besoj se mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë do ta keni gjithmonë.

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zonja Gjermani!

Fjalën e ka zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Në mbështetje të koleges Gjermani, dua t’ju falënderoj për punën që keni bërë, pasi nuk është e lehtë të bësh një punë të tillë kur institucioni është i ri, por pa dyshim organizimi dhe puna në grup ka sjellë këto rezultate.

Një falënderim të veçantë kam për botimin e fundit që keni bërë “Diaspora shqiptare” dhe shpresoj që së shpejti të dalë numri i dytë.

Ne si anëtarë të nënkomisionit, nga debatet dhe takimet e ndryshme që kemi bërë na interesojnë shumë statistikat, prandaj mendoj se ky libër është një *database* shumë i mirë për të gjithë kontributin e diasporës shqiptare, por edhe për të kuptuar në shifra reale se sa është ky kontribut. Nga ana tjetër do t’ju sugjeroja, në mënyrë miqësore, që në projektet tuaja të ardhshme të kemi 2-3 aktivitete të përbashkëta me nënkomisionin, pasi nga ana jonë ky bashkëpunim nuk do t’ju mungojë.

Pa dyshim, ju jeni shumë të kujdesshëm, por do të ishte mirë të mendonim ndonjë kontribut të përbashkët edhe jashtë formatit të mbledhjes.

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Më lejoni të bëj edhe unë një koment përfundimtar për raportimin e ministrit të Shtetit për Diasporën nga njëra anë dhe për drejtoreshën e Fondit Shqiptar për Diasporën nga ana tjetër.

Sinqerisht, jam shumë i kënaqur, si dhe vlerësoj të gjithë punën e bërë nga institucioni i ri i krijuar në vitin 2017 si pjesë e qeverisë shqiptare. Vlerësoj në mënyrë të jashtëzakonshme kontributin e zotit Majko në ngritjen e gjithë strukturës së re, pasi dora e tij ndihet qoftë në organizimin faktik që i bëri gjithë institucionit, tre ligjeve të kaluara në parlamentin e Republikës së Shqipërisë, konsistencës së treguar në miratimin e kuadrit ligjor, si dhe shtyllave serioze që u mundësuan dhe u ngritën.

Unë sinqerisht në fillim kam qenë shumë skeptik kur kaloi përbërja e qeverisë dhe struktura lidhur me ecurinë, por sot, kur e shikoj, jemi 2 vjet pas krijimit të këtij institucioni, së bashku me

organogramën dhe strukturën e këtij institucionit na bën të ndihemi krenarë si në nënkomisionin e diasporës, në Komisionin e Jashtëm dhe në parlamentin shqiptar.

Ne ndihemi krenarë që ka një frymë të tillë në gjithë punën dhe organizmin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, në aktivitetet periodike dhe në ndërgjegjësimin e gjithë komunitetit shqiptar nëpër botë, për sensitivitetin e çështjes kombëtare, të marrëdhënieve me shtetin amë dhe gjithçka tjetër.

Më lejoni t'ju siguroj, zoti Ministër, që mbështetja jonë si nga ana e Nënkomisionit për Diasporën dhe e Komisionit për Politikën e Jashtme do të jetë e pakushtëzuar. Ju do të keni të gjithë mbështetjen tonë në zhvillimin e projekteve, të ideve që gjeneron si ministri i Shtetit, ashtu edhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në veprimtarinë tuaj periodike. Mënyra e raportimit, mënyra e transparencës dhe e funksionimit në gjithë institucionin tuaj, sinqerisht na bën të ndihemi krenarë, sepse është i veçantë nga të gjitha raportimet e institucioneve të shtetit shqiptar, e këtu pa dyshim është roli i zotit Majko si strateg i drejtimit të shtetit shqiptar, prandaj në këtë mision që ai ka në drejtimin e këtij institucioni pa dyshim ndihet dora e tij.

Edhe një herë më lejoni t'ju falënderoj dhe t'ju uroj punë të mbarë për vitin në vazhdim!

Ne do të ngelemi në kontakt të vazhdueshëm. Këtu mbështes edhe sugjerimet e kolegëve të Nënkomisionit për Diasporën dhe Emigracionin, që ne jemi të hapur për bashkëpunime të tjera për të qenë pjesë e projekteve të përbashkëta me qëllim që veprimtaria juaj, fryma e gjithë aktiviteteve të institucionit të ministrit të Shtetit për Diasporën të jenë kuptimplote, të gjenerojnë ide, bashkëpunim të mëtejshëm midis gjithë aktorëve dhe faktorëve që janë dhe kontribuojnë në këtë fushë.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**